

# Genc Hoti - Peza dhe Mukja

Contributed by Jozef Martini  
Sunday, 14 September 2014

Peza dhe Mukja

Genc Hoti

Peza dhe Mukja

Genc K. Hoti

Sivjet kemi 65 vjetorin e marrëveshjes së Mukjes dhe 66 vjetorin e Konferencës së Pezës(\*), por asnjë historian nuk ka arritur të zbulojë sekretin e Mukjes, një sekret me të vertete të tmerrshme për historinë e komunizmit propagandistik shqiptar. Ajo që është mbajtur e fshehtë, me një diktaturë ekstreme, nuk është zbuluar akoma dhe asnjë historian shqiptar nuk është i aftë t'i përgjigjet pyetjes me të thjeshtë fare: c'ndryshim ka Peza nga Mukja? Akoma nuk është kuptuar se Mukja është e pavleshme pa Pezën dhe Peza e pavleshme pa nacionalistët atdhetarë.

Ne qofte se do t'i hedhim një sy studimeve dhe fjaloreve enciclopedike (pas 1992) për keto dy ngjarje do të zbulojmë se të dy mbledhjet kanë të njëjten performancë propagandistike: organizimi i forcave politike kundër okupatorit. Ateherë ku qëndron ndryshimi dhe përse duheshin mbajtur dy mbledhje me të njëjten përmbajtje (në fakt nuk janë të tilla në thelb) brenda 10 muajve të gjysëm? Çfarë fshihet pas këtij fakti?

Zbulimi i akteve të formimit të PKSh, dmth data dhe vendi, çuan në kërkesën për rishikimin e të gjithë të kaluarës së ngjarjeve që lidheshin me komunizmin shqiptar dhe konkretisht me Pezën historike. Çfarë ka ndodhur në Pezë më 16 shtator 1942? Ka shumë enigma që duhen zgjidhur dhe përse u kerkua bashkimi i të gjithë forcave nacionale në luftë kundër fashizmit. Në fund të fundit: kush ishte kjo forcë, pasi këtu qëndron edhe sekretin e Mukjes. Problemi ka nevojë për pak interpretim pasi shumë gjëra janë ndryshe nga ajo që dinë shqiptarët e shekullit të vjetër.

Konkretisht në Shqipëri, në vjeshtën e 1942, ekzistonin disa forca nacionaliste në veri dhe në jug pa asnjë lidhje me njëra – tjetrën: Balli Kombëtar në Jug dhe Legaliteti në Veri, por ekzistonin dhe forca nacionaliste pa bosht politik aktual, por që përfshiheshin në rrymat antizogiste si forcat e Myslim Pezës në perëndim të Tiranës, ato të Haxhi Lleshit në Dibër dhe Vogel dhe forcat e Hysni Lepenicës në Labëri; dy të parat përfshiheshin në inteligjencën shqiptarë me një edukacion evropianorëndimor që anonte nga shkollat gjermano-austriake, ndërsa tre të fundit përfshiheshin në forcat popullore jashtë politikave shtetërore. Komunizmi shqiptar (behët fjalë për partinë komuniste të Shkodrës) në këto kohe ndodhej i mberthyer nga intrigat e dy jugosllaveve me tendencë eliminimin total të tyre dhe në vjeshtën e 1942-shit ishte i çorganizuar totalisht. Në këto kushte kërkohet bashkimi i tyre pasi, siç po shihej, Italisë Fashiste po i vinte fundi. Fakti që mbledhja nuk u bë në Jug, ku ndodhej qendra e Ballit Kombëtar (në thelb një lëvizje antizogiste) dhe as në Veri, ku ndodhej qendra mbretërore, duhet të tregojë se këto dy forca politike ishin diametralisht të kundërta në qëllimet e tyre. Por fakti që mbledhja u bë në Pezë duhet të tregojë se Babë Myslimi ishte, trashmë, një personazh antifashist i deklaruar dhe i palidhur me asnjë forcë politike të mësipërme, por me një menjanim nga krahu antizogist. Me sa kemi kuptuar të dy forcat politike kryesore ja kanë pasur nevojën udhëheqësit pezak pasi ato nuk mund të realizonin kurrë atë që bënte rebeli antizogist kundër fashizmit. Në këtë pikë gjërat duhen thënë siç janë dhe jo si na pëlqen. Në këtë fazë lidhja e Myslim Pezës me forcat komuniste ka qënë inekzistente dhe kjo përbën të panjohurën e parë për lexuesin shqiptar. Plaku i mëvonshëm i Pezës historike e pranoi pazarin me Enver Hoxhën dhe, sa ishte gjallë, asnjëherë nuk deklaroi se në atë kohë komunistët i takonin modës politike dhe nuk kishin asnjë lidhje me Pezën. Pikërisht kjo i është nevojitur diktatorit shqiptar dhe këtë e shfrytëzoi në mënyrë perfekte, prandaj dhe krijoi atë lidhje të ngushtë me Babë Myslimin dhe e nderoi sa ishte gjallë. Plaku i historisë ja mbajti besën autorit të antihistorisë dhe asnjëri nuk mori vesh në Shqipëri se Enver Hoxha nuk kishte lidhje me Pezën historike; kjo përbën të panjohurën e dytë për lexuesin shqiptar.

Në këtë mënyrë në Pezë antifashiste u formua aleanca nacionaliste kundër okupatorit fashist me pjesëmarrjen e të gjitha

forcave politike ku roli i Myslim Pezës duhet konsideruar ndër më kryesorët. Kjo duhet vënë në dukje pasi këtë pikë shfrytëzoi më vonë Enver Hoxha për të realizuar intrigën e vet historike dhe pikërisht kjo anashkalohet duke i fshehur shqiptarëve të vërtetat historike siç kanë ndodhur dhe jo si na pëlqejnë të kenë ndodhur. Në këtë pikë historiografia shqiptare, pas 1992-shit, në vënd që t'i bjerë gozhdës i ra patkoit me qëllimin e vetëm pse nuk di të interpretojë aktin e madh të luajtur në Pezë më 1942. A nuk është kjo një pikë ku padija përzihet me politikën dhe është kjo e fundit që i fsheh popullit shqiptar realitetin historik të së kaluarës? Pikërisht në këtë pikë kemi rolin negativ të Akademisë së Shkencave të RPSSH e cila asnjëherë nuk e nxorri në dritë të vërtetën e Pezës Historike. Peza nuk i përket komunizmit, por nacionalizmit shqiptar dhe është pika ku populli shqiptar mund të krenohet njësoj si më 1912, 1878-1881, apo 1444.

Pas shtatorit 1942 në Shqipëri duhet të kete filluar lufta e organizuar kundra okupatorit fashist dhe kjo vetem për arsien e deshtimit të operacioneve italiane kundra popullit grek për të cilin u pushtua Shqipëria më 1939 dhe jo me perpara. Spontaniteti i luftimeve antiitaliane duhet t'i dedikohet vetëm çetes se Pezes dhe ndoshta Haxhi Lleshit në Dibër (ne te vertete nuk disponojme ndonjë të dhënë mbi kohën e antifashizmit dibran) e Hysni Lepenicës në Jug. Dinamika e antifashizmit shqiptar është teper e varfer dhe as që ja vlen të permendet. Kete situatë nuk mund ta pranoni forcat angleze, prandaj dhe organizuan komunizmin me të vetmin qëllim për të vene ne krye të shtetit shqiptar njeriun e tyre, por që ishte kunder interesave të nacionalizmit shqiptar.

Ky është momenti i krijimit të situatës ne prag të Mukjes të cilin vetem komunistet e dinin, ndersa nationalistet ishin vene ne gjume duke kujtuar se shtetin shqiptar kishin për ta drejtuar ata pas largimit të italianëve. Por këtu duhen pasur parasysh disa probleme, jo të vogla, jashtë paragykimeve edukative që na ka dhënë shkolla shtetërore përpara 1992-shit. Së pari duhet sqaruar që roli i forcave antifashiste nuk ishte i aftë të çlironte vëndin nga pushtimi fashist, të paktën me raportet e forcave ekzistuese. Së dyti roli i shtabit partizan ishte zero për kohën e shkurtër të ekzistencës, pasi në kohën e kapitullimit të Italisë fashiste forcat që komandonte ky shtab ishin partizanët e 62 çetave dhe 1 brigade me rreth 4000 partizanë të llogaritur për limitin maksimal. Por arësyeja që PKSh trumbetoi fitoren mbi fashizmin ishte marrja përsipër e fitoreve të çetave nacionaliste që ajo i asgjësoi më vonë përgjatë periudhës 1943-1944 në Jug dhe 1945-1948 në Veri. Kjo gjë pranohet me gjysëm zëri në një formë të maskuar edhe nga autori i historisë së krijimit të PKSh (për herë të parë) sipas të cilit është gabim të thuhet se lufta nacional-çlirimtare ishte thjeshtë luftë për dëbimin e okupatorit (Ndreçi Plasari, Krijimi i Partisë Komuniste të Shqipërisë (1939-1941), f. 39). Ishin pikërisht këto çeta që luftuan kundra fashizmit pushtues në kohën kur komunistët prisnin dadon angleze t'i merrte për dore dhe t'i tregonte platformën e re të luftës nga antizogizmi në antifashizëm. Paaftësia për tu organizuar si parti politike më vete bëri që komunistët shqiptarë të fshiheshin gjatë pushtimit fashist. Kaq e vërtetë është kjo sa e detyron anglezin, me pikëpamje të majta Riginald Hibertin, të pranojë se në mars 1943 në Labinot u mbajt konferenca themeluese e PKSh (Reginald Hebert, Fitorja e hidhur, f. 334). Sipas "Historia e luftës antifashiste nacional-çlirimtare të popullit shqiptar", në fund të vitit 1942 kanë qënë 2000 luftëtarë në mbi 30 çeta partizane (Historia e luftës antifashiste nacional – çlirimtare të popullit shqiptar, V. 1, f. 148), të cilin numër Historia e PPSH, e zgjeron edhe në njësite guerile (Historia e PPSH, bot. 1, f. 97). Por ne kemi një të dhënë nga një burim krejt i kundërt, por më i besueshëm se të gjithë të tjerë. Sipas këtij burimi "Në të gjithë Shqipërinë veprojnë sot rreth 40 çeta rebelësh, me një forcë komplekse prej 6 000 veta, nga të cilët rreth 1.500 vetë janë në veprim të vazhdueshëm luftarak" (Piero Crociani, Shqiptarët në forcat e armatosura italiane 1939 – 1943, f. 291), por pa bërë asnjë specifikim të mëtejshëm (flitet gjithmone para kapitullimit të Italisë).

Në këto rrethana forcat nacionaliste, duke ditur formimin e PKSh dhe të shtabit komunist, i propozojnë kësaj të fundit bashkimin për idealin e vetëm të çlirimit të Shqipërisë nga fashizmi, të cilit i kishte ardhur ora e vdekjes dhe që politikanët nacionalistë e kishin kuptuar. Pikërisht në këtë pikë qëndron ndryshimi midis Pezës dhe Mukjes; dmth në Pezë nuk kishte komunistë, kur në Mukje komunistët u ftuan për të qënë anëtarë me të drejta të plota në aleancën e madhe antifashiste. Dihet se si përfundoi ajo konferencë, por nuk dihet dinamika e përmbyesjes së saj nga komunistët. Pa kaluar dy javë nga marrëveshja e Mukjes komunistët u mblodhën në Vithkuq për të formuar brigadën e tyre të parë dhe të hidhin poshtë atë marrëveshje duke treguar qëllimin e tyre real edhe pse ishin krejt të pafuqishëm përballë realitetit historik. A nuk tregon kjo se prapa komunistëve shqiptarë fshihej një forcë shumë herë më e fuqishme se ajo e jugosllavëve, kur këta të fundit ishin vetëm krahët e mashës historike. Çfarë ndodhi me 15 gusht 1943 në Vithkuq? Kjo përbën të renë për lexuesin shqiptar të shekullit të ri.

Rendesia e 15 gushtit 1943, për ne, nuk qëndron në mohimin e Mukjes apo formimin e brigades se pare. Ajo dite ka një te dhene të vecante për Enver Hoxhen dhe për anetaret e delegacionit komunist në Mukje duke nxjerrë në dritë se kush ishin ata që e përmbyesën Mukjen. E dhena nuk ka goditje individuale dhe merita e saj qëndron në mosangazhimin e politikës kundra Enver Hoxhes pa e ditur se si do të vine ngjarjet pas një viti. Vini re se çfare ka ndodhur atë dite në Vithkuq sipas një pjestari okular, dikur brenda vathes komuniste e pastaj kundra saj, dhe pozicionin e diktatorit të ardhëshëm kundrejt drejtuesve të PKSh të asaj kohe.

Në një artikull me titull "Kush e vrau Mustafa Gjinishin?" të botuar në gazetën "Bashkimi i Kombit" datë 31 gusht 1944, Nr 205, me autor Xhelal Staraveckën (ish komandant i batalionit të II-të të brigadës së I-rë dhe i larguar nga ai post për të njëjtat shkaqe si për rastin e Ndoc Çobës), jepet e gjithë panorama hapsinore e asaj që ka ndodhur midis 1 dhe 2 gushtit 1943 në Mukje dhe me 15 gusht në Vithkuq. Në atë artikull thuhet:

"Partia rebele gjakatare, në vjetin e kaluem (1-2 gusht 1943, GH), e dërgoi Mustafa Gjinishin, që tani e vrau, bashkë me Dr. Ymer Dishnicën, që sigurisht do ta vrasë (ndoshta ky paralajmërim e shpëtoi doktorin e urtë nga vdekja e sigurtë, GH), në mbledhjen e Mukajt për tu bërë bashkimi i të gjithë shqiptarëve. Të dy delegatët, të udhëhequr nga ndjenjat e vëllazërimit, u bashkuan me rrymat dhe me organizatat nacionaliste të Shqipërisë. Dihet mirë si ç'asht shfaqun shpesh herë dhe me shkrime se sërbianët Dushani dhe Miladini, e thyen bashkimin e vendosur në Mukajt për të realizuar ëndrat e vllavrasjes, në të cilën ndodhemi sot. Kam ndodhur vetë, në vendimin e dënimit me vdekje të Mustafa Gjinishit dhe të Ymer Dishnicës, që aderuan në bashkimin e Mukajt. U dënuan, por nuk u ekzekutuan, pse Mustafa Gjinishi dhe Dr. Ymer Dishnica ishin

popullarizuar në Shqipëri dhe vrasja e tyre mund të krijonte përçarje të tmershme në Partinë rebele, pse, Partia nuk i kishte rrëmbyer akoma frenat e fuqisë në dorë. Përveç kësaj, vrasja e Mustafait, mundej të krijonte përçarje edhe ndërmjet Myslim Pezës dhe Partisë rebele, pse Myslimi e kishte dhandër Mustafa Gjinishin. Në vendimin e dënimit të Gjinishit dhe të Dishnicës me vdekje në Vithkuq, ku kam ndodhur edhe vetë, kanë marrë pjesë këta persona: në krye të mbledhjes Druzhe Miladini, në të djathtën e tij Sejfulla Malëshova; mbas tij Enver Hoxha; në krah të Enverit Spiro Moisiu; mbas Spiros Dushan Gogozhani (kemi përshtypjen se duhet të jetë Dushan Mugosha, GH); mbas këtij vinte i nënshkruemi, mbas të nënshkruemit Mehmet Shehu. Rrethi mbyllesh në krahun e majtë të Miladinit me Fiqret Sanxhaktarin, Jovana e dyte e Napolit...”

Këto rreshta, në funksion të temës sonë, nuk kanë nevojë për interpretim, pasi pozicioni e forcave nacionaliste kundrejt komunisteve, dhe i këtyre të fundit kundrejt jugosllavëve, është mjaft i qartë, por ne na intereson dinamika e zhvillimit të PKSh në ato vite dhe i figurës së Enver Hoxhës në krye të partisë komuniste. Të gjitha këto tregojnë se Mukja shërbeu, sipas interesave të jugosllavëve – angleze, për të forcuar Partinë gjakatare dhe ngritur figurën e Enverit. Të dyja këto përbëjnë sekretin e madh përse u prish marrëveshja e Mukjes dhe çfarë përfaqësojnë dueti Parti Komuniste – Enver Hoxha; ato perbejne sekretin e madh se kush ishte aleati i vertete i Enver Hoxhes. Anglezet nuk kane qene aleate te nacionalisteve shqiptare, por kundërshtarët me të eger të tyre.

---

(\*) Shkrimi mban datën 2 gusht 2008, kur edhe u publikue ne Albanovaonline.